



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

Datë: 04.08.2025

Numër Protokolli: 5223/2025

A.nr.1102/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1102/2025, të datës 10.06.2025, të parashtruar nga ankuesi, P.K, nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit/ Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.08.2025 mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1102/2025, e datës 10.06.2025 e parashtruar nga ankuesi, P.K.

II.Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 05.06.2025 për kandidatin fitues nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, në konkursin e shpallur me nr.reference RN00017147, Grupi i tekologjisë informative, pozita Zyrtar i lartë i TI-së për sisteme, klasa e pozitës, Profesional 1.

A r s y e t i m

Ankuesi, P.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 10.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3902/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1102/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference **RN00017147**, të shpallur sipas Konkursit publik të datës 01.04.2025, nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Grupi i tekologjisë informative, pozita Zyrtar i lartë i TI-së për sisteme, klasa e pozitës, Profesional 1, numri i kërkuar 1.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia për

Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa kjo e fundit, më datë 02.07.2025, ka përcjellë përgjigjën në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me nr prot 3902/2025 të datës 10.06.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konursit e datës 01.04.2025 me numër reference RN00017147; Njoftimi i datës 12.05.2025 për refuzimin e aplikacionit nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit; Njoftimi i datës 30.05.2025 për shpalljen e testit me shkrim; Renditja përfundimtare e kandidatëve fitues e datës 05.06.2025; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.07.2025; Përgjigje në ankesë e datës 02.07.2025 nga organi I punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Lista e aplikantëve; Lista e kandidatëve të aprovuar; lista e kandidatëve të refuzuar; Njoftimi i datës 13.05.2025 për listen e verifikimit paraprak; Vendimi me nr.protokolli 632/2025 I datës 15.05.2025 për themelimin e Komisionit të vlerësimit për praninë bashkë me Akt Emërimit e anëtarëve të komisionit; E-mali I datës 03.06.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të Komisionit të datës 05.06.2025; Njoftimi për rezultatet përfundimtare e datës ; Aplikacioni I datës 03.04.2025 I kandidatit P.K; E-mali i datës 13.05.2025 dhe Aplikacioni i datës 18.04.2025 I kandidatit F.S.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit më datë 01.04.2025 ka bërë njoftimin për shpalljen e konkursit për “Grupi i Teknologjisë informative” për pozitën “Zyrtar i lartë i TI-së për sisteme” klasa Profesional 1, me afat të aplikimit nga data 02.04.2025 deri më datë 01.05.2025 me nr. RN00017147, ndërsa kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për fushën e shkencave kompjuterike, inxhinieri kompjuterike dhe softuerike, Informatikë inxhinierike, Teknologji e informacionit dhe Telekomunikim, Informatikë dhe Teknologji Informative, Inxhinieri Kompjuterike me telekomunikacion, Kërkesat specifike : Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase, Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.**

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se konkursi me nr. RN00017147 “Grupi i teknologjisë informative” pozita Zyrtar i lartë i TI-së për sisteme, klasa profesional 1 është shpallur në pajtim me Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe katalogun e vendeve të punës.

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo të njëjtit përmes njoftimit të datës 12.05.2025 Njësia e Burimeve Njerëzore ia ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, respektivisht kualifikimin arsimor, sepse ankuesi posedon diplomën me nr. 248/14 të datës 03.11.2014 të lëshuar nga Kolegji Iliria me të cilën ka marrë titullin Bachelor(BSC) në shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Informative dhe po ashtu i njëjti nuk ka dëshmi për përvojën e punës në fushën e TI-së.

Kolegji, ka konstatuar se në përputhje me dispozitat e lartshënuara në këtë arsyetim sa i përket kualifikimit arsimor NJMBNJ në Agjencinë për Parandalimin e Antikorrupsionit ka vërtetuar drejtë argumentet faktike dhe gjendjen juridike kur ka vendosur të refuzoj aplikacionin e ankuesit sa i përket kriterëve të kualifikimit arsimor, sepse ankuesi nuk posedon diplomë në drejtimet e kërkuar

nga shpallja e konkursit siç është thënë më lartë dhe po ashtu i njëjti nuk posedon dëshmi për përvojën e punës në fushën e TI-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit të ankuesit se i njëjti i ka plotësuar kriteret e konkursit është i pabazuar sepse konkursi është i shpallur konform Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 7 ku përcaktohet se” ***Parimet e pranimi në detyrë të zyrtares/it publik 1. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese***” si dhe në harmoni me Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurat e Pranimi në Shërbimin Civil respektivisht neni 5 ku përcaktohet se “ ***Shpallja e procedurës së rekrutimit 1. Shpallja e procedurës së rekrutimit përmban të paktën këto të dhëna: 1.1. vendin e punës; 1.2. përshkrimin e përgjithshëm të punës; 1.3. kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së; 1.4. kriteret specifike shtesë, nëse ka; 1.5. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit; 1.6. mënyrën për paraqitjen e aplikacioneve; 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të përcaktuar me datë të saktë; 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre; 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve; 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët***”

Po ashtu Kolegji ka vlerësuar edhe dosjen e kandidat fitues dhe ka konstatuar Aplikacioni i F.S i datës 18.04.2025 posedon: Diploma e datës 20.03.2003 me nr.70 i cili me datë 25.09.2022 ka mbaruar Fakultetin e Elektroteknikës drejtimi kompjuterikë me telekomunikacion në Fakultetin e Elektroteknikës në Universitetin e Prishtinës dhe ka këtë përvojë pune: Vërtetimin e datës 26.04.2021 me të cilën vërtetohet se prej datës 27.11.2002 e deri më datë 31.12.2013 ka kryer detyrën e zv.Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Komunën e Istogut; Vërtetimin e datës 04.05.2015 të lëshuar nga shkolla e Mesme Teknike “Mithat Frashëri “ në Gurrakoc-Istog me të cilin vërtetohet se i njëjti prej datës 01.09.2011 punon mësimdhënës i elektroteknikës drejtimi informatikë në lëndët : gjuhë programuese , baza të të dhënave dhe sisteme operative ku ka vazhduar , Me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës me Nr.34/2021 të datës 12.05.2021 është emëruar anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës.

Prandaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstatoi se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me rastin e zhvillimit të procedurave të konkursit për pozitën Zyrtar i TI-së për sisteme ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe katalogun e vendeve të punës.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara të ligjit material, si dhe Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, dhe pas konstatimit se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara, vendosi që ankesën e tij ta refuzoi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ka lënë në fuqi Njoftimi i datës 05.06.2025 për kandidaten fitues.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda

afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1102/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, P.K;
- Njësisë se Personelit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.